REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr3988 Prot. Maliq, më 26.06.2026

VENDIM
Nr.89, datë 25.06.2026
PËR

"MIRATIMIN E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT KULTUROR "NETËT E MALLIT"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 8 pika 2, neni 9, pika nënpika 1.1, gërma "b", neni 25 "Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese", neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e Këshillit bashkiak*", gërma "dh", neni 55 *"Votimi"* pika 3, neni 64 *"Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë"* gërma "c",ligjit 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 32 "Përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore", të ligjit Nr.68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 45 "Rishpërndarja e fondeve buxhetore", të ligjit Nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 14.01.2025 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2026", mbështetur në vendimin Nr. 148 datë 24.12.2025 të Këshillit Bashkiak Bashkia Maliq "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2026", ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", ligjit nr. 25/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën" dhe VKM nr.1173, datë 6.11.2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e Qeverisjes Qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura", Këshilli Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

1. Miratimin për mbështetje financiare prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh për aktivitetin artistik "Netët e Mallit"

2. Miratimin e datave të aktivitetit 10 dhe 11 gusht 2026.

3. Financimi i Projektit do të përballohet nga buxheti i bashkisë i vitit 2026.

NATA I	**VLERA**
Maestro Piano / Drejtues Orkestre	20.000 lekë
Baterist	20.000 lekë
Basist (Kitarë Bas)	20.000 lekë
Saksofonist	20.000 lekë
Këngëtar	30.000 lekë
Kitarist	20.000 lekë
Violinist	20.000 lekë
Totali Nata I	**150.000 lekë**
NATA II	**VLERA**

NATA II	VLERA
Baterist	20.000 lekë
Basist	20.000 lekë
Kitarist	20.000 lekë
Violinist	20.000 lekë
Këngëtar	30.000 lekë
Totali Nata II	**110.000 lekë**
Përshkrimi	**Vlera**
Pagesa artistësh dhe instrumentistësh për **dy netët** artistike	260.000 lekë
Dekor ambienti, elementë skenikë, ndriçim dekorativ dhe materiale zbukuruese	90.000 lekë
Kostumografi dhe veshje artistike	50.000 lekë
Totali	**400.000 lekë**

4.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Kulturës në bashki.

5.Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 21vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA MALIQ